

BULETIN MUJOR



Administrohen me sukses provimet e Maturës Shtetërore 2026

Mbi 26,600 maturantë në të gjithë vendin përfunduan provimet në një process të rregullt, të zhvilluar me standarde, barazi, në një mjedis të qetë dhe të sigurt për të treguar njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë viteve të shkollimit. Matura Shtetërore këtë vit u administrua në 144 qendra provimesh, me mbi 2000 mësues administratorë dhe 170 monitorues nga Ministria e Arsimit. Ndërkohë, 640 vlerësues të testeve përmbyllën në kohë dhe me korrektësi procesin e vlerësimit, duke bërë të mundur publikimin e rezultateve sipas afateve të përcaktuara.



Shkolla Verore 2026, programi përfshiu 47 shkolla

Programi “Shkolla Verore 2026” u zbatua në 47 shkolla, 45 në Tiranë dhe 2 në Kamëz, me pjesëmarrjen e rreth 7,500 nxënësve. Përmes një kalendari të larmishëm aktiviteteve dhe klubeve të artit, sportit, muzikës, mjedisit dhe teknologjisë, ky program krijoi mundësi për edukim, argëtim kreativitet e kohë cilësore. Zbatimi i programit u mbështet nga World Vizion dhe një staf i gjerë mësuesish, punonjësish socialë, oficerë sigurie dhe vullnetarë nga gjimnazet. Bashkëpunimi me institucione kulturore e artistike pasuroi programin me një larmi aktiviteteve të zhvilluara si brenda, ashtu edhe jashtë mjediseve të shkollës.



Përmbyllet programi EU4Schools, Kumbaro: 63 objekte arsimore dhe kushte moderne për 25 mijë fëmijë

U zhvillua Konferenca përmbyllëse e programit “EU4Schools”, financuar nga Bashkimi Evropian, në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare dhe zbatuar nga UNDP. Në kuadër të programit u rindërtuan dhe u rehabilituan 63 objekte arsimore në 11 bashki të vendit, duke krijuar kushte moderne dhe të sigurta për rreth 25 mijë nxënës. Programi mundësoi ndërtimin e klasave të reja, pajisjen e mbi 120 laboratorëve shkencorë e teknologjikë, trajnimin e mësuesve, krijimin e hapësirave për mbështetje psikosociale dhe forcimin e standardeve të sigurisë në shkolla.



Nis puna për Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2027-2031

Ministria e Arsimit dhe UNICEF prezantuan nisjen e punës për Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2027-2031. Kjo strategji vendos nxënësin në qendër, me qëllimin për të konsoliduar një sistem arsimor gjithëpërfshirës. Një sistem ku çdo fëmijë, pavarësisht vendbanimit, statusit social apo kushteve familjare, të ketë mundësi të barabarta për të mësuar, për t’u zhvilluar dhe për të realizuar potencialin e tij. Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar 2027-2031 pasqyron vizionin e Shqipërisë për një sistem arsimor gjithëpërfshirës, inovativ, të barabartë dhe të orientuar drejt së ardhmes, në përputhje me standardet evropiane.



Ministrja Kumbaro inspekton kampusin e ri të Kolegjit të Europës në Tiranë

Janë drejt përfundimit punimet për kampusin e ri të Kolegjit të Europës. Ministrja e Arsimit, Mirela Kumbaro, së bashku me Rektoren në detyrë të Kolegjit të Europës, Ewa Ośniecka-Tamecka, dhe përfaqësues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, inspektuan ecurinë e punimeve në kampusin e ri të Kolegjit të Europës në Tiranë. Ky investim strategjik do të krijojë një hapësirë moderne për Kolegjin e Europës dhe një pjesë të kampusit të Universitetit të Tiranës, duke përmirësuar kushtet për studentët dhe stafin akademik, si dhe duke forcuar ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë në Shqipëri.



Përfundon faza e parë e Trajnimit të Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2026-2028

U mbyll me sukses faza e parë e trajnimeve të Programit Kombëtar për Zhvillimin Profesional të Mësuesve 2026-2028, i cili përfshiu 13.282 mësues nga e gjithë vendi. Programi i Zhvillimit Profesional synon fuqizimin e kompetencave profesionale të mësuesve dhe njohjen e tyre me metodologjitë bashkëkohore të mësimit, kurrikulat e reja mësimore, si dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe inteligjencës artificiale në procesin mësimor. Trajnimet në bashkëpunim me 9 universitetet publike do të rifillojnë më 30 shtator për të mbështetur më tej zhvillimin profesional dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit parauniversitar.